



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 21.7.2021

- Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 21.7.2021, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Shkëlqim Miri
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 26.4.2021, është njoftuar vendimi nr. 374, datë 23.4.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*në vijim Komisioni*), i cili ka vendosur: *“Të deklarojë të ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit, pasi është dënuar me vendim të formës së prerë”*.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit.

I. Vlerësimi i Komisionerit Publik mbi interpretimin ligjor të Komisionit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlqim Miri, në mbështetje të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka informuar Komisionin mbi vendimin nr. ***, datë ***.10.2020, “Për caktimin e masës disiplinore”, me anë të cilit KLGJ-ja ka vendosur shkarkimin nga detyra të magjistratit Shkëlqim Miri, pasi ka konstatuar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. ***, datë ***.11.2018, ka deklaruar fajtor z. Miri, për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”¹. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. ***, datë ***.2.2019.

¹ Të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe është dënuar përfundimisht me dy vjet burgim. Në përfundim, KLGJ-ja është shprehur, ndër të tjera, se: ... Këshilli arrin në përfundimin se, në zbatim të parimit të ligjshmërisë dhe të parimit të mosdënimit pa ligj, rezultoi e provuar se magjistrati Shkëlqim Miri është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për

3. Pas konsultimit me faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, konstatojmë se për çështjen penale themeli, me të pandehur Shkëlqim Miri, ***, ***, dhe kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është regjistruar rekurs më datë ***.5.2019, statusi i saj është në *studim*, me relator gjyqtarin ***, ***. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë do të jap efekt edhe mbi vendimet e marra, si rrjedhojë e vendimit të dënimit të formës së prerë të rekursuar në Gjykatën e Lartë.

4. Komisioneri Publik vëren se Komisioni, në të njëjtat rrethana, dhe duke arsyetuar me të njëjtën bazë ligjore, në vendimin nr. 316/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Ibrahim Hoxha, ka vendosur për: *përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.*

5. Ashtu sikurse jeni në dijeni, Komisioneri Publik ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit vendimin nr. 316/2020 të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Ibrahim Hoxha, duke kërkuar, ndër të tjera, që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe të orientojë Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, mbi nevojën për saktësimin e bazës ligjore, arsyetimin ndryshe të vendimit dhe, sipas vlerësimit të Kolegjit, saktësimin e dispozitivit në pikën 1 të tij.

II. Kërkimi i ankimit

6. Nisur nga fakti se standardi i përdorur nga Kolegji është i njëjtë për të gjitha subjektet dhe bazuar në nenin F/3 të aneksit të Kushtetutës, sipas së cilit: *Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetueshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj;*

7. Kërkojmë që vendimi nr. 374, datë 23.4.2021, të merret në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë alternative, të vendosë:

- Ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit
ose
- Lënien në fuqi të tij.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA